



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-313 - 5709 dt. 31/01/ 2019

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Udhëzimit Administrativ nr.2007/02 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, nenin 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe kërkesës nr.04-070-68986, të datës 20.11.2018, të subjekteve që merren me veprimtarin e Barnatoreve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 31.01.2019 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Biznesit në Komunën e Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Plotesim ndryshimi i Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes se organizatave të biznesit në komunen e Drenasit.

Neni 2

Ndryshohet neni 15 paragrafi 15.1, 15.2, i Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes së organizatave të biznesit në komunen e Drenasit, dhe atë:

- a) Periudha verore, ndryshohet nga 08:00 - 20:00, në 08:00 - 21:00,
- b) Periudha dimërore, ndryshohet nga 08:00 - 20:00, në 08:00 - 19:00,
- c) Vikendeve dhe gjatë festave zyrtare do të kujdestarohet 24h, përjashtimisht në raste urgjente mund të punohet edhe jashtë orarit të paraparë më lartë.

Neni 3

Pas aprovimit të ndryshimeve të lartecaktuara do të njoftohen të gjitha subjektet e prekura dhe drejtorit përkatëse në Komunën e Drenasit.

Neni 4


Perveq paragrafit 15.1 dhe 15.2, dispozitat tjera të Rregullores Nr.12-313-5137, të dates 28.04.2013 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punes së organizatave të biznesit në komunën e Drenasit, mbasin të pa ndryshuara.

Neni 5

Pas aprovimit të plotesim ndryshimit të lartcekur, shfuqizohet Vendimi Nr.031-52786, i datës 07.09.2016, i Kuvendit të Komunes së Drenasit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Glogoc, Republic of Kosovo. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "KOMUNA GLOGOC" in the middle, and "REPUBLIKA E KOSOVES" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Kosovo. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink. To the right of the signature, the text "Kryesuesi i Kuvendit të Komunës" is printed. Below the signature, the name "Pajtim Hafilaj" is handwritten.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Pajtim Hafilaj